



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:277996

Datë: 25.07.2022

Numri i dokumentit: 03260877

**PKR.nr.211/21**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – Departamenti për Krime të Rënda**, Kryetari i trupit gjykues Sami Sharaxhiu si dhe anëtarët e trupit gjykues – gjyqtarët Violeta Husaj Rugova dhe Veton Ademaj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Tringa Zhuti, në çështjen penale ndaj të pandehurit N.I, nga fshati L., Komuna D., për shkak të veprës penale *mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve* nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe për veprën penale *gjueti e kundërligjshme* nga neni 350 par.1 dhe 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTHDKR në Pejë në PP/I.nr.254/21 të dt.22.12.2022, në prezencën e prokurorit të shtetit Valbona Disha Haxhosaj, të pandehurit N.I si dhe mbrojtësit të tij av.Isa Kelmendi nga Peja, sipas detyrës zyrtare, me datën 18.07.2022 muarr dhe publikisht shpalli ndërsa me datën 25.07.2022 punoi këtë :

**A K T G J Y K I M**

**I PANDEHURI:**

**N.I**, i lindur me datë ... në P. ndërsa jeton në fshatin L, Komuna D., i biri H. dhe V., e gjinisë A., i martua - baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, me profesion bujk, i gjendjes së dobët ekonomike, shfrytëzues i pensionit të veteraneve të luftës, i njohur sipas numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri.

**ËSHTË FAJTORË**

**Për shkak se:**

**I.** Me datë 28.10.2021, rreth orës 13:50 min., në fshatin L., Komuna D., i pandehuri në kundërshtim me nenin 23 par.2 dhe 3 të Ligjit për armë (Ligji nr.05/L-22), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll dhe atë: një ( 1 ) pushkë gjysmë automatike , pushkë me laser 10 ( dhjetëshe), prodhim k., kalibër 7.62 X 39 m.m , një pushkë gjuetie e prodhimit turk, kalibër ..., një ( 1 ) tytë e kalibrit të rëndë e modelit të panjohur, njëqind e njëzet ( 120 ) copë fishek të kalibrit 7.62X 39 m.m, njëzet e pesë ( 25 ) copë fishek ...,një ( 1 ) këllëfë i pushkës së gjuetisë, në atë mënyrë që ditën kritike , pasi që policia e Kosovës kanë marrë një informatë se i lartcekuri ka postuar në rrjetin social f.. një video duke gjuajtur në derr me pushkë dhjetëshe dhe me të marrë këtë informatë, policia e kontaktojne të pandehurin N.I, me ç’rast ky i fundit pranon se ja në posedim

armët e lartcekura, më pas policia shkojnë në vendin e lartcekur dhe në shtëpinë e tij konfiskojnë armët dhe municionin me të dhënat e lartcekura.

- me çka ka kryer veprën penale *mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim tepa autorizuar të armëve* nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

**II.** Me datë 19.10.2021, rreth orës 11.00, në vendin e quajtur “G. e L.”, Komuna D., i pandehuri N.I gjuan dhe mbyl kafshë të egra pa autorizim, në atë mënyrë që ditën kritike, pasi që i pandehuri shkon në vendin e lartcekur, ku për një çast ka vërejtur një derr duke shkuar në drejtim të tij, i pandehuri menjëherë merr armën - pushkën automatike dhe gjuan në drejtim të tij, me ç’rast godet me plumba dhe si pasojë e kësaj goditje, derri kishte ngordhur.

- me çka ka kryer veprën penale *gjueti e kundërligjshme* nga neni 350 par.1 dhe 2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata, konform nenit 2, 4 pae.1 nën par.1.2 dhe 1.3, nenit 7, 8,9, 10, nenit 38,39 par.1 nën par.1.2 dhe 1.3, nenit 46 par.1 nën par.1.1, nenit 47,48,49, nenit 76 par.1 dhe 2, nën par. 2.2, nenit 366 par.1 , nenit 350 par.1 dhe 2, nenit 366 par.3 të KPRK-së, të pandehurin e gjykon :

Për veprën penale nga pika 1 ( një ) e dispozitivit të aktakuzës, gjykata i përcakton :

**Dënim me burg në kohëzgjatje prej 9 ( nëntë ) muajve .**

Për veprën penale nga pika 2 ( dy ) e dispozitivit të aktakuzës, gjykata i përcakton :

**Dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 ( gashtë ) muajve .**

**Konform nenit 76 par.1 dhe 2 nën par.2.2 të KPRK-së, gjykata të pandehurin e gjykon me :**

**Dënim unik me kusht**, ashtu që ia përcakton dënimin unik me burg, në kohëzgjatje prej 1 ( një ) viti, e të cilin dënim unik me burg, i pandehuri nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 ( një ) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësorë, gjykatës të ia paguaj shumën prej 50 ( pesëdhjetë) euro, si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, shumën prej 50 ( pesëdhjetë) euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ( pesëmbëdhjetë) ditëve nga plotfuqishmëria e aktgjykimit.

Konform nenit 366 par.3 të KPRK-së , të pandehurit, i shqiptohet Dënimi plotësues, ashtu që një ( 1 ) pushkë gjysmë automatike , pushkë me laser 10 ( dhjetëshe), prodhim k., kalibër 7.62 X 39 m.m , një pushe gjuetie e prodhimit t., kalibër .., një ( 1 ) tytë e kalibrit të rëndë e modelit të panjohur, njëqind e njëzet ( 120 ) copë fishek të kalibrit 7.62X 39 mm, njëzet e pesë ( 25 ) copë fishek ...një ( 1 ) këllëfë i pushkës së gjuetisë, konfiskohen dhe të njëjtat pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, urdhërohet që të shkatërrohen.

### *Arsyetim*

PTHDKR në Pejë, ndaj të pandehurit N.I nga fshati L., Komuna D., ka ngritur aktakuzë, për shkak të veprës penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga

neni 366 par.1 të KPRK-së dhe për vepër penale gjueti e kundërligjshme , nga neni 350 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, me propozim që të caktohet shqyrtimi gjyqësor dhe pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, i pandehuri të shpallet fajtor, të dënohet sipas ligjit si dhe të obligohet në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale si dhe njëherit armët si mjete me të cilat është kryer vepra penale të konfiskohen dhe të njëjtat pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të urdhërohen që të shkatërrohen.

Në shqyrtimin kryesor të datës 15.07.2022, palët në procedurë në fjalën përfundimtare kanë deklaruar si në vijim :

Prokurori i shtetit Valbona Disha Haxhosaj në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas administrimit të provave e në veçanti pras pranimi dhe të njoftimit mbi rezultatin e kërkimit të sistemit IBIS në bazë të cilit njoftim është vërtetuar se pas ekzaminimit të armës të gjatë të zjarrit e njëjta është funksionale dhe nuk është vërejtur asnjë defekt gjatë operimit të qitjeve provuese. Po ashtu pas ekzaminimit përfundimtar të një pushke të gjahut është vërtetuar se kjo armë e gjatë e zjarrit është e dizajnuar për gjah, e njëjta është funksionale dhe nuk është vërejtur asnjë defekt gjatë operimit të qitjeve provuese, pushka e gjahut shkrep dy fishke në mënyrë të një pas njëshme pas tërheqjes të dy këmbëzave të armës dhe është e prodhuar në T. Pushka gjysmë automatike shkrep fishekët në mënyrë gjysmë automatike dhe është e prodhuar në K. si dhe të dhënat e tjera në këtë raport, është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri N.I ka kryer veprat penale të cekura në aktakuzë në vend , kohë dhe mënyrë të përshkruar si në aktakuzë, andaj i propozoi gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor, dhe ta dënoi sipas ligjit si dhe ta obligoi në kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale. Po ashtu i propozoi gjykatës që me rastin e përcaktimit lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata të merr parasysh rrezikshmërinë dhe mënyrë e kryerjes për veprën e dytë – gjueti e kundërligjshme kurse rrethana tjera nuk kam gjetur, kurse konform nenit 366 par.3. të KPRK-së, i propozoi gjykatës të konfiskohen armët një pushtë gjysmë automatike , pushkë me laser dhjetëshe prodhim k.kalibër 6.72 x 39 mm, një pushkë gjuetie e prodhimit t.kalibër , një tytë e kalibrit të rëndë e modelit të panjohur, 120 copë fishek të kalibrit 7.62 x 39 mm, 25 copë fishek .., një këllëf i pushkës së gjuetisë .

Mbrojtësi i të pandehurit N., av. Isa Kelmendi fjalën përfundimtare e ka përgatitur në formë të shkruar dhe një kopje ia ka dorëzuar prokurorit të shtetit dhe gjykatës si pjesë përbërëse e shkresave të lëndës, me propozim që gjykata në këtë çështje penale të merr aktgjykim të ligjshëm dhe njëherit të mbrojturin e tij ta liroi nga shpenzimet e procedurës penale ngase i njëjti është veteran i luftës dhe i njëjti gjithashtu e ka gjendjen e vështirë ekonomike. Më tutje ka deklaruar se tek i mbrojturi i tij nuk ka ekzistuar dashja për ta kryer veprën penale nga pika një e dispozitivit ngase i njëjti kishte pëlqim nga organi kompetent për dhënien e armës. Ndërsa për veprën penale nga pika dy e dispozitivit, kjo vepër sipas mbrojtjes nuk ekziston ngase gjuetia në atë kohë ka qenë e lejuar dhe atë sipas vendimit të Qeverisë nga data 10.10.2021 e deri me dt.31.01.2022.

I pandehuri N.I në fjalën përfundimtare drejtë për së drejti në procesverbal ka deklaruar se në tërësi pajtohet me fjalën përfundimtare të shkruar nga ana e mbrojtësit të tij dhe tjetër nuk ka se çka të shtoi .

Gjykata në këtë çështje juridiko penale i ka administruar të gjitha provat dhe atë në lidhshmëri logjike dhe faktike me njëra tjetrën si në vijim: është lexuar shënimi zyrtar i hetuesit N. N. dhe A. Z. i datës 28.10.2021, procesverbali mbi kontrollon dhe sekuestrimin e përkohshëm i datës 28.10.2021, lista e armëve të konfiskuara e datës 28.10.2021, lista e dëshmimeve për armët e sekuestruara datës 01.11.2021 , deklarata e të pandehurit N.I e dhënë në polici me datën 21.10.2021 dhe me në prokurori me datën 21.12.2021, skica e objekteve të kontrolluar, poligoni i shenjtarisë “K.“, certifikata e datës 22.10.2011 dhe ajo e datës 16.05.2021, kontratën mbi shitblerjen e armës, kontrata e pranimit dorëzimit e datës 05.08.2019 ,është bërë shikimi i foto dokumentacioni në shkresat e lëndës , pëlqimi për legalizimin e armës e lëshuar nga Ministria e punëve të Brendshme e datë 19.06.2019 nga SP D., Libreza e anëtarësisë si anëtarë i shoqatës së Gjuetarëve A. S. me seli në D., si dhe vendimi i MPB i datës 28.09.2021 – REF –.../.. mbi hapjen e sezonit të gjuetisë të vitit 2021- 2022 si dhe është dëgjuar edhe mbrojtja e të pandehurit N.I .

I pandehuri N.I në mbrojtjen e tij të dhënë në gjykatë me dt. 09.06.2022 ka deklaruar se unë jam anëtar i shoqatës së gjuetisë nga viti 2012 , çdo herë kam qenë anëtarë i rregullt i kësaj shoqate, kam marrë pjesë në të gjitha aktivitetet sa i përket shoqatës së gjuetisë deri kur ka ndodhur ngjarja dhe aty nuk kam dalë drejtë për së drejti që ta vrahë derrin, ka qenë ditë e diel dhe ka qenë lejuar gjuetia dhe unë i kam lëshuar zagarët në trajnim dhe një derr i egër më ka mësyre mua dhe zagarët ku shihet edhe në video dhe unë pastaj kam gjuajtur në drejtim të derrit, gjuetia ka qenë e lejuar, nuk dalim gjithnjë që ta vrahim gjahun por nganjëherë dalim dhe që të i ushtrojmë qentë e edhe si rekreacion. Policia e ka marrë vesh në bazë të postimit në rrjetet sociale pastaj më kanë thirrë në telefon pas një jave nga hetuesia në D. dhe më kanë thënë që të lajmërohem aty dhe unë kam shkuar dhe pastaj jam njoftuar se për çka kam qenë i ftuar. Sa i përket datës në polici që kam deklaruar se kam dal në gjueti datën 19.10.2021 kjo ka mundur me qenë gabim teknik nga ana ime sepse këtë e kam thënë në bazë të postimit në rrjet social. Armën e kam pasur pushkën 10 –she, gjysmë automatike me laser prodhim K., vetëm kam pasur pëlqimin për legalizim, të lëshuar nga SP D. me datën 19.06.2019.Për pushkën e gjuetisë prodhim T., e kalibrit .. , nuk kam pasur leje por e kam pasur kontratën e shitblerjes të vitit 2012 , kam aplikuar në momentin kur e kam blerë por kur kam shkuar në polici me rastin e nxjerrjes së certifikatës nën hetime mua më ka dal një ndalesë gjegjësisht e pa kryer lëndë penale në Prishtinë dhe ata më kanë thënë se pa u kryer kjo lëndë nuk bën që të aplikohet për leje të armës , kjo ka ndodhur diku në vitin 2012 diku një ose dy ditë pas blerjes së armës .Kur më ka përfshirë amnistia për lëndën në Prishtinë atëherë kam shkuar që të aplikoi prapë me kontratë të shitblerjes por nuk ma kanë pranuar në polici ngase më kanë thënë se tani duhet vërtetuar te noteri , kur kam shkuar tek noteri ma kanë kërkuar edhe pronarin e mëparshëm të pushkës së gjuetisë dhe kur kam shkuar që ta kërkoj shitësin e pushkës në shtëpi, në derën e tij e kam parë afishen se i njëjti kishte ndëruar jetë, pastaj kam vazhduar me djemtë e tij por noteri në Gjakovë më ka thënë se duhet të bëhet trashëgimia e të ndjerit por ata ende nuk e kanë bërë trashëgimin. Nuk më

kujtohet mirë në Stacion policorë në D., e di që aty kanë qenë ata punëtorët dhe unë i kam dorëzuar shkresat por ata i kanë humb sepse unë jam interesuar edhe tani por ata në Stacion policor në D. më thanë se ne nuk dimë se ku janë ato shkresa.

Gjykata, pas administrimit të provave dhe atë në lidhshmëri logjike dhe faktike me njëra tjetrën e vërtetoi gjendjen faktike si në vijim:

I pandehuri në mbrojtjen e tij nuk e ka mohuar faktin se armët e sekuestruara nga ana e policisë e të cilat kanë qenë në posedim të tij , i ka pasur pa leje, gjegjësisht nuk kanë qenë të legalizuara edhe përkundër faktit se i njëjti deklaroi se ka provuar që ta merr lejen nga organet kompetente, mirëpo me asnjë provë nuk e ka vërtetuar pretendimin e tij se ka aplikuar përveç se pretendon se ka aplikuar në Stacionin Policor në D., por ata i kanë humbur dokumentet si dhe pretendimin se i ka dy certifikata, mirëpo ato certifikata dëshmojnë se i njëjti ka njohuri teorike dhe praktike për përdorimin e duhur të armëve, ndërsa sa i përket kontratës për shitblerjen e armës të lidhur me dt.02.04.2022 në mes të të pandehurit si blerës dhe të shitësit B. G. për të cilin pretendon se ka vdekur, kjo kontratë është e pa legalizuar , gjegjësisht nuk është vërtetuar fare, ndërsa pretendimin e të pandehurit se personi me emrin B. G. nga i cili e kishte blerë armën, ka vdekur, i pandehuri me asnjë provë nuk e vërtetuar në gjykatë se ky person ka vdekur edhe pse të gjitha këto pretendime të të pandehurit, nuk ishin fare relevante për këtë çështje, ngase në rastin konkret i pandehuri nuk kishte leje për asnjërin prej armëve gjë që nuk e mohoj një fakt të tillë e në rastin konkret i njëjti sipas pikës një të aktakuzës, akuzohet pikërisht për mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjithashtu, i pandehuri në mbrojtjen e tij ka deklaruar se derrin e egër e kishte vlarë me dt.17.10.2021, kur ishte ditë e diele dhe kur lejohet gjuetia , mirëpo sipas shkresave të lëndës i njëjti në F. e ka postuar vrasjen e derrit me dt.19.10.2021, ditë e martë në ora 11.00, gjë që e kishte pranuar në polici me dt.28.10.2021, por më vonë e kishte ndryshuar datën, pastaj i njëjti pretendon se gjuetia në atë kohë ka qenë e lejuar me vendimin e Qeverisë së Kosovës, mirëpo sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës për hapjen e sezonit të gjuetisë 2021-2022, .../.. të dt.28.09.2021 , gjuetia është e lejuar vetëm të dielave, e në rastin konkret ka qenë e martë, pastaj gjuetia organizohet në bazë të këtij vendimi dhe bëhet nga menaxherët e vend gjuetive si dhe nën mbikëqyrjen e organeve përgjegjëse të MBPZHR dhe komunave përkatëse ku zhvillohet gjuetia , pastaj duhet të ketë leje me shkrim nga menaxheri i vend gjuetisë, gjë që në rastin konkret nga ana e të pandehurit nuk është plotësuar asnjë nga këto kushte.

Andaj , duke u nisur nga administrimi i provave në lidhshmëri logjike dhe faktike me njëra tjetrën si dhe nga mbrojtja e të pandehurit, gjykata ka konstatuar se në veprimet e të pandehurit N.I , ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale , mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve, nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale gjueti e kundërligjshme , nga neni 350 par. 1 dhe 2 të KPRK-së.

Gjykata, me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin , për të pandehurin N.I konform nenit 69 të KPRK-së, i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese , si rrethanë

lehtësuese gjykata mori për bazë mos dënueshmërinë e gjertanishme të të pandehurit si dhe gjendjen e dobët ekonomike të tij ngase i njëjti jeton nga pensioni i veteranit të luftës , ndërsa gjykata rrethana rënduese mori për bazë rrezikshmërinë shoqërore të shkaktuar me kryerjen e veprës penale, pra ka shtënë me armë të pa legalizuar ku përveç dërrit ka mundur të lëndohet edhe ndonjë person e që fatmirësisht nuk ka ndodhur, andaj edhe ia shqiptoi dënimin sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi e bindur thellësisht se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i sanksionit penal dhe i pandehuri do të parandalohet që në të ardhmen të kryej veprat tjera penale.

Gjykata, lidhur me shpenzimet e paushallit gjyqësor , ka vendosur konform nenit 450 par.1. dhe 2, të KPPRK-së ndërsa konform ligjit nr. 05/L-036 , ka vendosur lidhur me kompensimin e viktimave të krimit.

Gjykata, konform nenit 366 par.3 të KPRK-së, armët dhe municioni si mjete me të cilat është kryer vepra penale, i ka konfiskuar dhe ka urdhëruar që pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të njëjtat të shkatërrohen.

Andaj, nga sa u tha më lartë, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**  
**PKR.nr. 221/21, e datës 25.07.2022**

Bashkëpunëtorja Profesionale  
***Tringa Zhuti***

Kryetari i trupit gjykues  
***Sami Sharaxhiu***

**UDHËZIM JURIDIK**

Kundër këtij aktgjykimi , është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh , nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e përmes kësaj gjykate.